

---

**PROJEKTMARRËVESHJE BASHKIMI**

**ARKONSTUDIO SHPK**  
**KEG SHPK**

---

3 TETOR 2023



---

## Përmbajtja

|      |                                                                          |   |
|------|--------------------------------------------------------------------------|---|
| i    | Të dhëna mbi shoqëritë që marrin pjesë në bashkim.....                   | 3 |
| ii   | Baza ligjore e bashkimit. ....                                           | 3 |
| iii  | Baza ekonomike e bashkimit. ....                                         | 4 |
| iv   | Raporti i këmbimit të kuotave të shoqërisë që përthithet.....            | 4 |
| v    | Kushtet e ndarjes së kuotave të shoqërisë përthithëse.....               | 4 |
| vi   | Data e pjesëmarrjes në ndarjen e fitimeve në shoqërinë përthithëse. .... | 5 |
| vii  | Data kontabël e bashkimit. ....                                          | 5 |
| viii | Përparësi dhe privilegje të veçanta. ....                                | 5 |
| ix   | Pasojat e bashkimit për punëmarrësit (Plani social).....                 | 5 |



i Të dhëna mbi shoqëritë që marrin pjesë në bashkim.

Shoqëria që përthithet është shoqëria KEG shpk, e regjistruar me numër unik L91324017H, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me seli në adresën Rruga Mihal Duri, pallati nr. 59, kati përdhe, hyrja nr.4, Tiranë. Shoqëria ka kapital me vlerë 100 lekë të zotëruar si vijon.

| Ortaku       | Përqindja e pjesëmarrjes | Vlera e kapitalit të zotëruar në Lek |
|--------------|--------------------------|--------------------------------------|
| Krenar Dila  | 50%                      | 50                                   |
| Erjon Këri   | 50%                      | 50                                   |
| <b>TOTAL</b> | <b>100%</b>              | <b>100</b>                           |

Shoqëria përthithëse është shoqëria ARKONSTUDIO shpk, e regjistruar me numër unik L42019004I, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me seli në adresën Rruga Mihal Duri, Objekt nr. 33, Tiranë. Shoqëria ka kapital me vlerë 60.000.000 lekë të zotëruar si vijon.

| Ortaku       | Përqindja e pjesëmarrjes | Vlera e kapitalit të zotëruar në Lek |
|--------------|--------------------------|--------------------------------------|
| Krenar Dila  | 50%                      | 30.000.000                           |
| Erjon Këri   | 50%                      | 30.000.000                           |
| <b>TOTAL</b> | <b>100%</b>              | <b>60.000.000</b>                    |

ii Baza ligjore e bashkimit.

Kjo projekt marrëveshje është hartuar në përputhje me parashikimet e nenit 216 të ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar.

Në përputhje me parashikimet në Vendimet e Asambleve të Ortakëve të datës 2.10.2023 të të dyja shoqërive, shoqëria KEG shpk do të përthithet nga shoqëria ekzistuese ARKONSTUDIO shpk. Në përfundim të këtij operacioni të gjitha aktivet dhe pasivet e shoqërisë KEG shpk do të transferohen tek shoqëria ARKONSTUDIO shpk dhe shoqëria KEG shpk vlerësohet e prishur dhe do të çregjistrohet nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit pa kryerjen e likuidimit.

Operacioni i bashkimit me përthithje do të realizohet në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, nenet 214 deri 225.

Posaçërisht, në përputhje me vendimet e asambleve dhe parashikimet në nenin 216, pika 7, të Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, nuk do të përgatitet pasqyrë kontabël e shoqërisë siç parashikohet në pikën 5 të nenit 216 të të Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar.

Bashkimi do të realizohet nëpërmjet kësaj projekt marrëveshje, raportit të administratorëve, raportit të ekspertit si dhe mbështetur në pasqyrat financiare të tre viteve të fundit, përkatësisht 2022, 2021 dhe 2020.

### iii Baza ekonomike e bashkimit.

Të dyja shoqëritë kanë objekt të aktivitetit të ngjashëm, të fokusuar tek punimet dhe aktivitetet ndërtimore, në këtë kuptim vlerësohet se mbajtja e të dy shoqërive si njësi të veçanta rrit kostot administrative si dhe bën më të vështirë administrimin e përditshëm të veprimtarive. Rrjedhimisht, është më e arsyeshme që këto shoqëri të riorganizohen dhe të bashkohen me qëllim që të ekzistojë vetëm një shoqëri. Meqenëse shoqëria ARKONSTUDIO SHPK është njësi më e vjetër, me një historik tregtar më të gjatë, me volum më të madh të veprimtarive të kryera si dhe me vlerë më të lartë të balanceve financiare, atëherë ka më shumë vlera të vijoje të ekzistojë shoqëria ARKONSTUDIO SHPK dhe shoqëria KEG SHPK të përthithet prej saj.

### iv Raporti i këmbimit të kuotave të shoqërisë që përthithet.

Ortakët e shoqërisë KEG shpk që përthithet pranojnë kalimin e të gjitha aktiveve dhe pasiveve tek shoqëria përthithëse ARKONSTUDIO shpk në përputhje me marrëveshjen dhe raportin e ndarjes dhe në këmbim do të bëhen ortakë tek shoqëria përthithëse sipas një raporti të këmbimit që është i drejtë dhe i arsyeshëm.

Ortakët e shoqërisë KEG shpk që përthithet kanë pjesëmarrje në kuota të barabarta prej 50% secili, pra edhe kuotat që këta ortakë do të përfitojnë në shoqërinë përthithëse do të jenë të barabarta me njëra tjetrën.

### v Kushtet e ndarjes së kuotave të shoqërisë përthithëse.

Sikurse përshkruhet edhe në paragrafët e mëparshëm, shoqëritë që marrin pjesë në bashkim kanë të njëjtët ortakë dhe pjesëmarrja e tyre është në të njëjtat përqindje. Pra të dyja shoqëritë, edhe shoqëria KEG shpk që përthithet edhe shoqëria përthithëse ARKONSTUDIO shpk, zotërohen në nivelin 50% me 50% nga të njëjtët ortakë.

Rrjedhimisht, meqenëse nëpërmjet kalimit të aktiveve dhe pasiveve të shoqërisë që përthithet, ortakët sjellin kontribute të barabarta, si dhe meqenëse këta ortakë të shoqërisë që përthithet janë edhe ortakët aktualë të shoqërisë përthithëse, të cilët kanë pjesëmarrje të barabartë, rezultojnë që nuk duhet të ketë ndryshim të ortakëve dhe të nivelit të pjesëmarrjes së tyre në kapital.

Pra pas bashkimit me përthithje të shoqërisë KEG shpk, struktura e ortakëve dhe niveli i pjesëmarrjes në shoqërinë ARKONSTUDIO shpk do të rezultojnë si vijon.

| Ortaku       | Përqindja e pjesëmarrjes |
|--------------|--------------------------|
| Krenar Dila  | 50%                      |
| Erjon Këri   | 50%                      |
| <b>TOTAL</b> | <b>100%</b>              |

Nga bashkimi me përthithje nuk rezultojnë ndryshim i ortakëve si dhe i kuotave që zotërohen prej tyre, si dhe nuk do të rezultojë asnjë shumë e pagueshme në para.

vi Data e pjesëmarrjes në ndarjen e fitimeve në shoqërinë përthithëse.

Meqenëse pas përthithjes nuk ka ndryshime në strukturën e pronësisë, pra mbeten të njëjtët ortakë me të njëjtën përqindje të pjesëmarrjes, atëherë edhe ndarja e fitimeve mbetet e pandryshuar dhe nuk ka diferencime të tjera, rrjedhimisht ortakët e shoqërisë përthithëse marrin pjesë në ndarjen e fitimit në pjesë të barabarta sipas nivelit të pjesëmarrjes për të gjitha fitimet e mbartura dhe ato të realizuara gjatë periudhës para përthithjes dhe pas përfundimit të operacionit të bashkimit me përthithje.

vii Data kontabël e bashkimit.

Data kontabël e bashkimit do të konsiderohet dita e parë e muajit në të cilin do miratohet bashkimi në QKB. Nga kjo datë, të gjitha veprimet dhe ngjarjet ekonomike do të trajtohen nga pikpamja kontabël si të kryera nga shoqëria përthithëse dhe do të regjistrohen dhe paraqiten në librat kontabël të shoqërisë ARKONSTUDIO shpk.

viii Përparësi dhe privilegje të veçanta.

Administratorët e shoqërive që marrin pjesë në bashkim, nuk përfitojnë privilegje apo ndonjë përparësi të veçantë si pasojë e ndarjes.

Gjithashtu, audituesi ligjor që është caktuar për përgatitjen e raportit të bashkimit si dhe ekspertët kontabël të autorizuar të shoqërive që marrin pjesë në bashkim nuk do të kenë asnjë përparësi të veçantë apo privilegj të caktuar në procesin e bashkimit dhe këta do të jenë të pavarur në ushtrimin e detyrave dhe funksioneve të tyre.

ix Pasojat e bashkimit për punëmarrësit (Plani social).

Nga bashkimi me përthithje i shoqërisë KEG shpk nga shoqëria ARKONSTUDIO shpk nuk do të rezultojë ndonjë pasojë mbi punëmarrësit e shoqërisë apo përfaqësuesit e tyre. Punonjësit e shoqërisë KEG shpk që përthithet janë marrë në punë aktualisht nga shoqëria përthithëse ARKONSTUDIO shpk me kontrata të njëjta.

  
Nasjel Çiço  
Administrator  
ARKONSTUDIO shpk  


  
Elion Matja  
Administrator  
KEG shpk  


03.10.2023